

VENDIM
Nr. 30, datë 29.5.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 11.5.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (V) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: VLADIMIR MNELA

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

OBJEKTI: shfuqizimi i vendimeve nr. 805 (5370), datë 17.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 284, datë 23.12.2021 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2022-577, datë 7.6.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 29, pika 2, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 252/06-nr. R.G.N.R 3139/05, datë 6.5.2006, të ndryshuar dhe që ka marrë formë të prerë më datë 17.10.2007 të Gjykatës së Assize e Apelit Milano, kërkuari është dënuar me 30 vjet burgim për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje”, e kryer në bashkëpunim dhe “Armëmbajtja pa leje” (armë e ftohtë), të parashikuara respektivisht nga nenet 110 dhe 442 të Kodit Penal italian. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka paraqitur kërkesë për njohjen e këtij vendimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me qëllim transferimin e kërkuarit për vazhdimin e vuajtjes së dënimit me burgim në shtetin shqiptar.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 265 (5591), datë 23.12.2020, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së prokurorisë. Njohjen e vendimit penal të huaj italian të dhënë ndaj kërkuesit [...], ku ai është dënuar me 30 vjet burgim [...]. Bazuar në nenin 516 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) konvertimin e dënimit të caktuar sipas autoriteteve italiane [...]. Bazuar në nenin 78, paragrafi i parë, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (KP), “Vrasja me paramendim”, kërkuesit i caktohet një dënim prej 25 vjetësh burgim, si dhe bazuar në nenin 279, paragrafi i dytë, të KP-së “Prodhimi, blerja, shitja dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, kërkuesit i caktohet një dënim me pesë (5) vjet burgim. Në përfundim kërkuesit i caktohet një dënim i vetëm me 30 vjet burgim [...]”. Ky vendim rezulton se është dhënë në mungesë të kërkuesit dhe ka marrë formë të prerë për shkak se ndaj tij nuk është bërë ankim. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 805 (5370), datë 17.11.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi. Sipas kësaj gjykate, kërkesa nuk është shoqëruar me ankimin kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 265 (5591), datë 23.12.2020, në zbatim të neneve 147 dhe 420/1, pika 1, të KPP-së. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 284, datë 23.12.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 805 (5370), datë 17.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjykata e Apelit Shkodër, ndër të tjera, ka vlerësuar se arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi. Sipas gjykatës së apelit në rastin konkret nuk jemi përpara një vendimi klasik themeli, i cili është dhënë në mungesë të të pandehurit, por përpara një vendimi administrativ penal, që ka të bëjë me njohjen e një vendimi të huaj, ku kërkuesi ka shfaqur vullnetin e tij për fillimin e procedurave për njohjen e vendimit. Gjithashtu, gjykata e apelit ka vlerësuar se kërkuesi i kishte të gjitha mundësitë që të caktonte një avokat për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes, dhe nuk mund të pretendojë se ky procedim është bërë pa dijeninë e tij. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesi.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-577, datë 7.6.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së. Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, gjykatat më të ulëta kanë vendosur mospranimin e rivendosjes në afat, referuar parashikimeve të neneve 147 dhe 420/1 të KPP-së, pasi kërkuesi nuk i ka bashkëlidhur ankimin, dhe ky fakt është parashikuar në ligj si arsye për mospranimin e kërkesës. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet e kërkuesit, të cilat janë marrë në shqyrtim edhe nga gjykatat më të ulëta, nuk kanë të bëjnë me shkaqe të tjera të vlerësimit të provave, pasi që në momentin që kërkuesi nuk ka përmbushur kushtet formale, kërkesa, në thelb, nuk ka shkaqe për t'u vlerësuar. Gjithashtu, ai kolegji ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatës së apelit është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal.

6. Më datë 6.10.2022 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, nr. 805 (5370), datë 17.11.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. 284, datë 23.12.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2022-577, datë 7.6.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë vendosur mospranimin e kërkesës së tij për rivendosjen në afat. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 22.12.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi**, në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur pretendon se i është cenuar:

7.1 *E drejta e njoftimit*, pasi nuk i është njoftuar vendimi nr. 265 (5591), datë 23.12.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër që ka vendosur njohjen e vendimit penal të huaj. Ai pretendon se është vënë në dijeni të këtij vendimi më datë 24.11.2021, pas daljes së urdhrit të ekzekutimit. Gjithashtu, pretendon se gjykimi për njohjen e vendimit të huaj penal është zhvilluar në mungesë të tij dhe me avokat të caktuar kryesisht. Ai nuk kishte mundësi të vihej në dijeni për këtë vendim, pasi është marrë shumë kohë më vonë se Ministria e Drejtësisë të përcillte dokumentet për njohjen e vendimit penal në prokurorinë e rrethit gjyqësor të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit.

7.2 *Parimi i mosdënimit pa ligj*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 265 (5591), datë 23.12.2020, me të cilin ka njohur vendimin e huaj, ka dhënë një dënim më të rëndë se ai që parashikonte legjislacioni penal shqiptar për veprën penale në kohën e kryerjes së saj. Në kohën e kryerjes së veprës penale dhe të gjykimit të çështjes, legjislacioni penal shqiptar për veprën e kryer nga kërkuesi parashikonte dënimin me maksimum 25 vjet burgim. Parashikimi që ka bërë kjo gjykatë për dënimin e kërkuesit me 30 vjet burgim, bie në kundërshtim me legjislacionin penal.

7.3 *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor lidhur me të drejtën e aksesit substancial*, pasi arsyetimet e vendimeve nr. 805 (5370), datë 17.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nr. 284, datë 23.12.2021 të Gjykatës së Apelit Shkodër janë të kundërligjshme. Kërkesës për rivendosje në afat të ankimit i bashkohet ankimi kundër vendimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat, vetëm kur ajo bëhet për shkaqet e parashikuara në nenin 420/1 të KPP-së, për rastet fatore ose të forcës madhore. Në këtë rast kërkesa për rivendosje në afat nuk është bërë për asnjë nga këto shkaqe. Gjykata e apelit gabon në arsyetimin e saj, pasi nuk ka asnjë dispozitë procedurale që të bëjë dallimin nëse gjykimi është penal apo administrativ. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në këtë rast duhet të njësonte praktikën gjyqësore dhe të mbante një qëndrim nëse gjykatat shqiptare në rastet e njohjes së vendimeve penale të huaja mund të caktojnë një masë ose lloj dënimi të paparashikuar nga legjislacioni shqiptar.

8. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

8.1 Pretendimi i kërkuesit për *cenimin e standardit të arsytimit* është haptazi i pabazuar, pasi vendimet e kundërshtuara prej tij përmbajnë elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit të bërë nga kërkuesi, i ka bërë një interpretim gramatikor (literal) nenit 420/1 të KPP-së, duke e analizuar në tërësi dhe duke bërë lidhjen e paragrafëve të tij me njëri-tjetrin, për të arritur në përfundimin se kërkesa duhet të shoqërohet detyrimisht me ankimin kundër vendimit të gjykatës, i cili kërkohet të ankimohet me pasojë mospranimin e kërkesës. Gjithashtu, ky pretendim i kërkuesit që lidhet me cenimin e parimit të ligjshmërisë ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të

drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Kriteri i *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës kërkon që individi t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 24, datë 27.4.2023; nr. 12, datë 24.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 13, datë 10.3.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar edhe vendimin nr. 00-2022-577, datë 7.6.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të nisur prej tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë shkelur.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Vendimi më i fundit i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 7.6.2022, ndërsa ankimi kushtetues, është paraqitur nëpërmjet shërbimit postar më datë 6.10.2022. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi e plotëson edhe kriterin e legjitimitimit *ratione temporis*.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 265 (5591), datë 23.12.2020, me të cilin ka njohur vendimin e huaj, ka dhënë një dënim më të rëndë se ai që parashikonte legjislacioni penal shqiptar për veprën penale në kohën e kryerjes së saj. Ai ka pretenduar, gjithashtu, se ky vendim gjyqësor nuk i është njoftuar rregullisht, duke i cenuar të drejtën kushtetuese të njoftimit. Ndonëse ai i është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të riparuar dhe mbrojtur këto të drejta, ato nuk e kanë rivendosur kërkuenin në afatin e ankimit, duke arsyetuar në vendimet e kundërshtuara se kërkesës i duhej bashkëngjitur akti i ankimit, duke cenuar në këtë mënyrë edhe standardin e arsyetimit të vendimit.

15. Nisur nga thelbi i pretendimeve të parashtruara rezulton se është pikërisht për njoftimin e tij dhe për mosdënimin pa ligj që kërkuesi ka kërkuar të rivendoset në afat nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, Gjykata çmon ta shqyrtojë çështjen në aspektin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial në procesin gjyqësor për shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial

16. Kërkuesi ka pretenduar se arsyetimet e vendimeve të gjykatave objekt kërkesë janë të kundërligjshme dhe se kërkesës për rivendosje në afat të ankimit i bashkohet ankimi kundër

vendimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat, vetëm kur ajo bëhet për shkaqet e parashikuara në nenin 420/1 të KPP-së, për rastet fatore ose të forcës madhore. Sipas tij, në këtë rast kërkesa për rivendosje në afat nuk është bërë për asnjë nga këto shkaqe dhe gjykata e apelit gabon në arsyetimin e saj, pasi nuk ka asnjë dispozitë procedurale që të bëjë dallimin nëse gjykimi është penal ose administrativ. Gjithashtu, ai ka pretenduar se arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i pabazuar dhe në këtë rast ai kolegji duhet të njësonte praktikën gjyqësore dhe të mbante një qëndrim nëse gjykatat shqiptare në rastet e njohjes së vendimeve penale të huaja mund të caktojnë një masë ose lloj dënimi të paparashikuar nga legjislacioni shqiptar.

17. Sipas subjektit të interesuar, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit është haptazi i pabazuar, pasi vendimet e kundërshtuara përmbajnë elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit të bërë nga kërkuari, i ka bërë një interpretim gramatikor (literal) nenit 420/1 të KPP-së, duke e analizuar në tërësi dhe duke bërë lidhjen e paragrafëve të tij me njëri-tjetrin, për të arritur në përfundimin se kërkesa duhet të shoqërohet detyrimisht me ankimin kundër vendimit të gjykatës, i cili kërkohet të ankimohet me pasojë mospranimin e kërkesës. Gjithashtu, ky pretendim i kërkuarit, që lidhet me cenimin e parimit të ligshmërisë, ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 6, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjithashtu, Gjykata rithekson se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022. nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 42, datë 7.7.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye nuk vë në dyshim vendimin e gjykatave kombëtare, sipas nenit 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykata kombëtare është aq evident sa të karakterizohet si një "gabim i dukshëm", domethënë një gabim që asnjë gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë

ose të jetë i tillë që të prishë drejtësinë e procesit (*shih vendimin e GJEDNJ-së Bochan kundër Ukrainës (n. 2), nr. 22251/08, datë 5.2.2015, §§ 61 dhe 62*).

22. Në vështirësi edhe të kësaj jurisprudence të GJEDNJ-së, Gjykata do të analizojë nëse kërkuar i është kufizuar e drejta për akses substancial dhe nëse kufizimi i saj është i arsyeshëm dhe proporcional nga interpretimi ligjor i gjykatave.

23. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 420/1, pika 1, të KPP-së, për të cilin ka ngritur pretendimet kërkuar, Gjykata konstaton se palët rivendosjen në afat të ankimit kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit faktor ose të forcës madhore. Po sipas kësaj dispozite, kërkesa për rivendosje në afat shoqërohet së bashku me ankimin, me pasojë mospranimin. Ndërsa sipas pikës 2, kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 351 të këtij kodi, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

24. Në çështjen konkrete Gjykata vëren se kërkuar ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit që ka njohur vendimin e huaj penal, duke pretenduar se gjykimi ishte bërë në mungesë të tij dhe se nuk kishte dijeni për këtë gjykim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vlerësuar se kërkesa për rivendosjen në afat nuk është shoqëruar me ankimin kundër vendimit, i cili ka njohur vendimin e huaj, në zbatim të neneve 147 dhe 420/1, pika 1, të KPP-së. Sipas gjykatës së shkallës së parë, nga interpretimi literal i pikës 1 të nenit 420/1 të KPP-së, kërkesa për rivendosjen në afat të ankimit duhet të shoqërohet detyrimisht me ankimin kundër vendimit të gjykatës, i cili kërkohet të ankimohet dhe në rast të mosplotësimit të këtij kushti, ajo nuk duhet të pranohet. Ky interpretim i bërë nga gjykata e shkallës së parë është vlerësuar i drejtë dhe i bazuar në ligj nga gjykata e apelit. Po ashtu, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë zbatuar dhe interpretuar drejt ligjin procedural.

25. Gjykata vlerëson se neni 420/1 i KPP-së synon mbrojtjen dhe administrimin e mirë të drejtësisë, përmes plotësimit të kushteve formale të kërkesës për rivendosje në afat. Ky synim balancohet edhe me vetë interesat e kërkuar, i cili me iniciativën e tij vë në lëvizje gjykatën. Norma ligjore, në mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit nga gjykatat, plotëson kriterin e qartësisë dhe parashikueshmërisë, ndaj dhe në vlerësimin e gjykatës kërkuar, përmes përfaqësuesit ligjor, duhet të ishte i qartë paraprakisht për plotësimin e kushteve dhe konkretisht të detyrimit për t'i bashkëlidhur kërkesës aktin e kërkuar nga ligji, sipas formës dhe mënyrës së kërkuar nga ligji.

26. Për sa më lart, duke vlerësuar rëndësinë e administrimit të mirë të drejtësisë, në kuadër të interesit publik dhe në respektim të së drejtës për akses substancial, rezulton se interpretimi i bërë nga gjykatat për nenin 420/1 të KPP-së nuk është arbitrar. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuar për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial janë të pabazuara.

27. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa është e pabazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, për rrjedhojë duhet të vendoset rrëzimi i saj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 29.5.2023.

Shpallur, më 29.6.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë pjesërisht kundër: Ilir Toska, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen nr. 9 (V) 2022 të Regjistrat Themeltar, me kërkuar Vladimir Mnela, në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se pretendimet e kërkuar për vendimmarrjen e gjykatës që ka shqyrtuar kërkesën e tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, janë të bazuara, për rrjedhojë duhet të ishte vendosur pranimi pjesërisht i kërkesës dhe shfuqizimi i vendimit gjyqësor nr. 00-2022-577, datë 7.6.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë.

2. Kërkuar, edhe pse në objekt të kërkesës ka kundërshtuar formalisht vetëm këtë vendim, i ka shtrirë pretendimet e tij edhe në drejtim të procesit gjyqësor të njohjes së vendimit penal nr. 252/06-nr. R.G.N.R. 3139/05, datë 6.5.2006, të Gjykatës Assize të Apelit Milano, me të cilin është dënuar me 30 vjet burgim, për kryerjen e veprave penale “Vrasje me dashje”, e kryer në bashkëpunim dhe “Armëmbajtje pa leje” (armë e ftohtë), të parashikuara respektivisht nga nenet 110 dhe 442 të Kodit Penal Italian. Ky vendim është ekzekutuar nga autoritetet italiane të drejtësisë. Ndërsa kërkuar vuante dënimin me burgim, autoritetet italiane të drejtësisë kanë kërkuar njohjen e këtij vendimi për efekt të transferimit të tij dhe vazhdimin e ekzekutimit në Shqipëri të dënimit penal. Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë i ka dhënë rrugë kësaj kërkesë duke ia përcjellë dokumentacionin Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Mbi kërkesën e kësaj të fundit, mbështetur në Konventën Evropiane “Për transferimin e personave të dënuar”, Konventën Evropiane “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqësorve penale”, Marrëveshjen Shtesë të Konventës Evropiane “Për transferimin e personave të dënuar” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, nenet 512-516 të KPP-së dhe ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, vendimi penal i huaj është njohur me vendimin nr. 265 (5591), datë 23.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (*vendimi i njohjes të vendimit penal të huaj*). Me këtë vendim, bazuar në nenin 78, paragrafi i parë, të KP-së, kërkuar i është caktuar një dënim prej 25 vjetësh burgim dhe bazuar në nenin 279, paragrafi i dytë, të KP-së, edhe një dënim me 5 vjet burgim, ku në bashkim të dënimeve ndaj tij është caktuar një dënim i vetëm prej 30 vjetësh burgim.

3. Shqyrtimi i kërkesës dhe dhënia e vendimit të njohjes të vendimit penal të huaj është bërë në mungesë të kërkuar dhe në prani të një avokati të caktuar kryesisht nga gjykata. Vendimi i arsyetuar i është njoftuar po avokatit të caktuar kryesisht, i cili nuk ka paraqitur ankim ndaj tij. Pas kalimit të afatit të ankimit, vendimi ka marrë formë të prerë më 26.3.2021.

4. Mbi bazën e vendimit të njohjes të vendimit penal të huaj kërkuar është transferuar në Republikën e Shqipërisë për vazhdimin e ekzekutimit të dënimit me burgim të caktuar ndaj tij.

5. Sipas akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se më datë 4.11.2021, kërkuar i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit të njohjes të vendimit penal të huaj. Në

përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 805 (5370), datë 17.11.2021, ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë, me arsyetimin se ajo nuk është shoqëruar me aktin e ankimit kundër vendimit për të cilin kërkohej rivendosja në afat e së drejtës së ankimit, sikurse rezultonte nga interpretimi literal i pikës 1 të nenit 420/1 të KPP-së. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

6. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 284, datë 23.12.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të drejtë përfundimin e asaj gjykate në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e pikës 1 të nenit 420/1 të KPP-së. Ajo gjykatë ka parashtruar si argument edhe se në rastin konkret nuk jemi përpara një vendimi klasik themeli të dhënë në mungesë të pandehurit, por përpara një vendimi administrativ penal, që ka të bëjë me njohjen e një vendimi të huaj, ku kërkuesi ka shfaqur vullnetin e tij për fillimin e procedurave për njohjen e vendimit, ndaj ai i ka pasur të gjitha mundësitë që të caktonte një avokat për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes dhe për këtë arsye nuk mund të pretendonte se ky procedim është bërë pa dijeninë e tij. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-577, datë 7.6.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së. Sipas atij kolegji, referuar parashikimeve të neneve 147 dhe 420/1 të KPP-së, kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit nuk është pranuar pasi nuk i është bashkëlidhur ankimi dhe ky fakt është parashikuar në ligj si arsye për mospranimin e kërkesës, ndaj në momentin kur kërkuesi nuk ka përmbushur kushtet formale të kërkesës nuk ka shkaqe për t'u vlerësuar ajo. Gjithashtu, Kolegji Penal ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatës së apelit është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal.

8. Më datë 6.10.2022 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 805 (5370), datë 12.11.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. 284, datë 23.12.2021 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2022-577, datë 7.6.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë vendosur mospranimin e kërkesës së tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit të njohjes të vendimit penal të huaj.

9. Në këtë ankim kushtetues kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën e njoftimit, si dhe të parimit të mosdënimit pa ligj, pretendime këto që i adresohen procesit gjyqësor për njohjen e vendimit penal të huaj, i cili nuk është objekt i ankimit kushtetues. Pavarësisht kësaj, duke pasur parasysh natyrën e këtyre pretendimeve, Gjykata do të duhej t'i mbante në vëmendje në funksion të procesit tjetër gjyqësor objekt i këtij gjykimi, që ka vendosur për kërkesën për rivendosjen në afat, konkretisht në këndvështrim të pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial.

10. Shumica ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuetit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial, është i pabazuar, duke arsyetuar se neni 420/1 i KPP-së synon mbrojtjen dhe administrimin e mirë të drejtësisë, përmes plotësimit të kushteve formale të kërkesës për rivendosjen në afat. Ky synim balancohet edhe me vetë interesat e kërkuetit, i cili me iniciativën e tij vë në lëvizje gjykatën. Norma ligjore, në mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit nga gjykatat, plotëson kriterin e qartësisë dhe parashikueshmërisë, ndaj dhe në vlerësimin e gjykatës kërkueti, përmes përfaqësuesit ligjor, duhet të ishte i qartë paraparakisht për plotësimin e kushteve dhe konkretisht të detyrimit për t'i bashkëlidhur kërkesës aktin e kërkuar nga ligji, sipas formës dhe mënyrës së kërkuar nga ligji. Sipas saj, duke vlerësuar rëndësinë e administrimit të mirë të drejtësisë, në kuadër të interesit publik dhe në respektim të së drejtës për akses substancial, rezulton se interpretimi i bërë nga gjykatat për nenin 420/1 të KPP-së nuk është

arbitrar (*shih paragrafët 25 dhe 26 të vendimit*). Mbi këtë bazë shumica ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit.

11. Për përfundimin si më lart dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje, ne, si gjyqtarë në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm, duke vlerësuar se ky pretendim i kërkuarit është i bazuar dhe, për pasojë, kërkesa e tij, për sa i përket shfuqizimit të vendimit nr. 00-2022-577, datë 7.6.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duhej të pranohej.

12. Në rastin konkret, vlerësojmë se është i zbatueshëm vetëm neni 420/1 i KPP-së, i shtuar me ligjin nr. 35/2017, sipas të cilit: *“1. Palët rivendosjen në afatin e ankimit kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fitor ose të forcës madhore. Kërkesa shoqërohet së bashku me ankimin, me pasojë mospranimi. 2. Kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 351, të këtij Kodi, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin. 3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast ose forcë madhore, kurse në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për vendimin. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë dhe për çdo shkallë të procedimit ...”*.

13. Këto dispozita kanë përcaktuar kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës, konkretisht formën, subjektin dhe afatin. Nga ana tjetër, në to është parashikuar qartësisht edhe pasoja në rastin kur nuk plotësohen këto kërkesa ligjore. Ajo kërkon një kërkesë formale për rivendosjen në afat të ankimit, të shoqëruar me ankimin, i cili sigurisht duhet të plotësojë kriterin formal, sikurse kërkon edhe neni 412 i KPP-së. Megjithatë, kjo dispozitë, ndryshe nga sa kanë vepruar gjykata e zakonshme, nuk mund të interpretohet se përjashton mundësinë e përfshirjes së ankimit (elementeve formale të tij) brenda kërkesës për rivendosjen në afat, situatë e cila do të kënaqte atë kërkesë të ligjit për formalizimin e ankimit në funksion të miradministrimit të drejtësisë. Duke iu referuar akteve bashkëlidhur kërkesës në shqyrtim, rezulton se kërkuari ka paraqitur kërkesën formale për rivendosje në afat, por pa e shoqëruar atë me një akt tjetër formal të ankimit kundër vendimit të njohjes të vendimit penal të huaj. Megjithatë, referuar përmbajtjes së kërkesës, krahas pretendimeve për rivendosjen në afat të ankimit, rezulton që kërkuari të ketë parashtruar edhe pretendime në lidhje me vendimin e njohjes së vendimit penal të huaj, konkretisht për mohimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur për shkak të zhvillimit të procesit në mungesë të tij, pa pasur ai dijeni. Po kështu, në apelin e tij kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit, në funksion të këtij pretendimi kërkuari ka kërkuar garantimin e së drejtës për të pasur një gjykim të çështjes në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë rast, ai ka shtuar edhe një pretendim tjetër, për sa i përket vendimit të njohjes të vendimit penal të huaj, atë për zbatim të gabuar të ligjit penal ndërsa i është caktuar një dënim më i rëndë se ai që parashikonte legjislacioni penal shqiptar, për veprën penale të kryer në kohën e kryerjes së saj.

14. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2 datë 11.2.2021; nr. 7, datë 7.2.2017; nr. 6, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në këtë kuptim, shumica duhej të ndalej në mënyrën se si është interpretuar dhe zbatuar neni 420/1 i KPP-së nga gjykatat e zakonshme që kanë shqyrtuar kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit dhe nëse kjo mënyrë ka cenuar të drejtat substanciale të kërkuarit. Kjo çështje merr veçanërisht rëndësi, duke pasur parasysh dy fakte me natyrë kushtetuese: i) procesi i njohjes së vendimit penal për kërkuarin është bërë në mungesë dhe ai nuk ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtat kushtetuese; ii) pretendimet në thelb kanë të bëjnë me parimin e mosdënimit pa ligj, pasi vendimi penal i huaj ka dhënë një dënim më të rëndë se ai që parashikonte legjislacioni penal shqiptar për veprën penale të kryer, në kohën e kryerjes së saj.

16. Për nga natyra e pretendimeve dhe natyra e procesit gjyqësor në tërësinë e tij, gjykatat e zakonshme nuk duhej të mbanin një qasje të tillë formaliste, por të ushtronin funksionin e tyre kushtetues dhe ligjor, duke synuar të drejtën. Gjykatat e zakonshme kanë detyrimin që interpretimi që u bëjnë dispozitave ligjore gjatë zbatimit të tyre të shkojë drejt mbrojtjes së të drejtave të individit, veçanërisht atij që është dënuar e gjykuar në mungesë dhe nuk ka pasur asnjë mundësi të mbrohet ose të parashtrijë qëndrimin e tij. Të tilla qëndrime të gjykatave të zakonshme (duke pasur parasysh, rritet kështu, se në kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit kërkuari ka parashtruar edhe elementet formale të ankimit kundër vendimit të njohjes të vendimit penal të huaj) kthehen në kufizuese të të drejtave të individit dhe vënë në dyshim të drejtën për proces të rregullt.

17. Edhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj është shprehur se fakti që aplikanti ishte në gjendje të paraqiste çështjen e tij përpara një gjykate, nuk përmbush domosdoshmërisht në vetvete kërkesat e nenit 6§1 të KEDNJ-së. Rregullat që dispijlojnë hapat formalë që duhen ndërmarrë për paraqitjen e një ankimi synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Société Anonyme Sotiris dhe Nikos Koutras Attee kundër Greqisë, datë 16.11.2001; Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës, datë 19.12.1997; Saez Maeso kundër Spanjës, datë 9.11.2004*). Gjykatat kanë detyrimin që të sillen në atë mënyrë që të tilla kërkesa të mos e humbasin qëllimin e tyre dhe individit të mos i cenohet në thelb edhe e drejta për një mjet juridik efektiv. Në këtë kuptim, qasja e gjykatave në rastin konkret, duke verifikuar formalisht paraqitjen e kërkesës, pa u ndalur në leximin e saj tërësor, ka cenuar në thelb të drejtën e aksesit substancial të kërkuarit në gjykatë, për më tepër në kushtet kur ai nuk ka në dispozicion asnjë mjet tjetër juridik për të kërkuar rivendosjen e të drejtave të cenuara.

18. Duke pasur parasysh qëndrimin e gjykatave të zakonshme, në kuptim të pozicionit e funksionit të saj sipas nenit 141 të Kushtetutës, i takonte Gjykatës së Lartë, që t'i jepte një interpretim të drejtë normës ligjore në kuptim të zbatimit të saj në rastin konkret në zbatim të parimit të subsidiaritetit, pasi, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, në radhë të parë, funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata e Lartë, në arsyetimin e saj, ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatës së apelit është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal, në një kohë kur ajo, si argument për mospranimin e kërkesës për rivendosje në afat ka shtuar edhe se kërkuari ka pasur të gjitha mundësitë që në procesin e njohjes të vendimit penal të huaj të caktonte një avokat për të ushtuar të drejtën e mbrojtjes, prandaj nuk mund të pretendonte se ky procedim është bërë pa dijeninë e tij. Është e qartë se gjykata e apelit në këtë rast ka dalë jo vetëm përtej shkaqeve të ngritura në ankim, por edhe përtej kërkesës në shqyrtim për rivendosjen në afat të ankimit, duke kapërcyer kështu kompetencat e saj ndërsa ka vënë në diskutim dhe është shprehur për pretendime të kërkuarit në drejtë të procesit që lidhet me vendimin e njohjes së vendimit penal të huaj për të cilin ai kërkonte të rivendosej në afat ankimi. Jo vetëm kaq, por ky argument i shtuar nga gjykata e apelit kurrsesi nuk mund të shërbejë si shkak ligjor për të arritur në përfundimin e mospërmbushjes të kriterëve të pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit.

20. Nga ana tjetër, edhe shumica duhej të kishte evidentuar në rastin konkret problematikat që shoqërojnë këtë çështje, që në nivel kushtetues kanë sjellë mohimin e të drejtave të kërkuesit për t'u mbrojtur në procesin penal të njohjes së vendimit të huaj. Shumica, edhe pse në jurisprudencën kushtetuese është theksuar gjerësisht se i gjykuari në mungesë duhet të ketë të gjitha mundësitë që të kundërshtojë procesin penale ndaj tij, duke iu garantuar çdo e drejtë që buron nga dispozitat kushtetuese, nuk arriti të shkojë përtej vlerësimit formal të kriterëve ligjore që ka bërë edhe gjykata e zakonshme. Në vlerësimin tonë, të tilla çështje janë të rëndësishme jo vetëm për sa u përket të drejtave që kërkohen të mbrohen dhe që vihen në diskutim, por ato i japin mundësinë kësaj Gjykate të zgjerojë këndvështrimin dhe mbrojtjen kushtetuese të individit, veçanërisht kur bëhet fjalë për kufizimin e lirisë.

21. Në përfundim, ndryshe nga shumica, vlerësojmë se interpretimi që gjykatat e zakonshme i kanë bërë nenit 420/1 të KPP-së duket i paarsyeshëm, duke i cenuar kërkuesit të drejtën për akses substancial. Për pasojë, pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial është i bazuar, ndaj Gjykata duhej të vendoste pranimin pjesërisht të kërkesës, për rrjedhojë shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-577, datë 7.6.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimin e kësaj çështjeje për rishqyrtim në po atë gjykatë.

Anëtarë: Ilir Toska, Sonila Bejtja